



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHD

Data 25/07/2024

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
TE VEÇANTA PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Rikonstruksion i rruges per te kisha”**

**Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):** Asphalt-44113620-7

**VLERA E FONDIT LIMIT: 6 800 043 (gjashte milion e teteqind mije e dyzet e tre )  
leke pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**A. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë :**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi :** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme) :**

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :**

**2.2.1** Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabel.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, sidhebazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, sidheLigjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

**2.2.2** Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) , lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

**2.2.3.** Vërtetim të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 në të gjitha adresat ku operatori/operatorët ekonomik ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKR-se.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP sidhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistimin e taksave vendore” indryshuar, neni 5, pika c.

### **2.3 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:**

**a-** punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**b)** punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

#### **-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:**

**-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:** Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 9) i shoqëruar me: -Kontratë punimesh; -Situacion përfundimtar; -Akt-kolaudimi; -Faturat Tatimore, Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:** Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: - Kontratë punimesh, -Situacionin përfundimtar, -Akt-kolaudimin, -Çertifikatën e marrjes në dorëzim- Faturat tatimore për çdo situacion punimesh.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Investitorit.

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

## Punime të Përgjithshme Ndërtimi

- NP.1 A Punime gjurmimi në tokë
- NP.4 B Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- NP 7 A Ujshjellesa, gazshjellesa, vajsjellesa vepra kullimi e vaditje
- NP.12A Punime te inxhinierise se mjedisit

## Punime Speciale Ndërtimi:

- N.S-1 A, Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S-5 A, Impiantete sinjalistikes ndricuese te trafikut
- N.S-6 A, Sinjalistike rrugore jo ndricuese
- N.S 18 A, Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojne veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku jane te percaktuar kategorite perkatese dhe niveli i klasifikimit per licensat e subjekteve qe ushtrojn veprimtari ne fushen e ndertimit.

*Pikat e licensave jane percaktuar ne baze te zerave te pershkruara ne preventivin e projektit..*

*Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi.*

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
NP-1	Punime gjurmimi në tokë: Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore. mimi në	Punime gjurmimi dhe te themeleve te rrugeve me zinxhir deri ne 50 cm eskavator dhe	A	0-20 milion

	tokë.	shkarkim ne toke		
NP-4	Rrugë, mbikalime, ura, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	Punime per bazamentin e rruges dhe shtresat konsumuese te rruges .	B	21-50 milion
NP-7	Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje ;	Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me ndertime <i>Punime seksioni II</i> <i>Punime ne KUB,KUN</i> ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.	A	0-20 milion
NP-12	Punime te inxhinierise se mjedisit	Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të	A	1-20 milion

		kompaktësimet të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme.		
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune që kanë të bëjnë me punime prishje punime me blloqe , të cilat shtojnë të nevojshme që Operatori Ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë N.S-1A.	A	1-20 milion
NS-5	Impiante të sinjalistikës ndricuese të trafikut	Punime për ndricimin e segmentit	A	1-20 milion
NS-6	Sinjalistika rrugore jodriçuese	Punimet për sinjalisten horizontale dhe vertikale të parashikuara në preventiv.	A	0-20 milion
NS-18	Punime topogjeodezike.	Punimet për piketimin e pjerresive të rrugës sipas projektit	A	0-20 milion

**2.3.3.** Referuar preventivit, grafikut, specifikimeve teknike si dhe punimeve ndertimore, Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Gjeoteknik
- 1 (nje) Inxhinier Elektroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik

Për secilin nga drejtuesit teknike si me sipër te paraqitet :

- a) Kontrate pune;
- b) Diplome ;
- c) Libreze pune;
- d) CV ;

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. Për kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori i shoqërisë.

Operatorët ekonomik duhet të caktojë me anë të një dekaratë Drejtuesin Teknik të punimeve i cili duhet të jetë i përfshirë në license e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

*Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale jane:*

<i>1 (nje) Inxhinier Ndërtimi</i>	<i>Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit të punimeve (Punime Germimi dhe Prishje, punimet per nenshrasat rrugore , shtresat asfaltike sipas kuotave te dhena nga ing gjeodet )</i>
<i>1 (nje)Inxhinier Hidroteknik</i>	Ne preventivin fillestar percaktohen volume konkrete pune te domosdoshme per tu ndjekur nga inxhinieri hidroteknik persa i perket volumit te pergjithshem te parashikuar ne preventiv
<i>1 (nje) Inxhinier Gjeodet</i>	<i>Eshtë përgjegjës për punimet per profilat terthore duke dhene pjerresite sipas kushteve te zbatimit</i>
<i>1 (nje) Inxhinier Mjedisi</i>	Kerkohet inxhinier mjedisi pasi kemi te bejme me punime germimi, ndertimi, heqje dherash etj, qe kane ndikim negativ ne mjedisin perreth. Gjate zbatimit te projektit, eshte e pashmangshme qe ne realizimin e punimeve te kete mbeturina e inerte te cilat paraqesin rrezikshmeri per komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet te realizohet ne perpikmeri dhe ne kohe reale, prandaj asistenca e nje inxhinieri mjedisi do te jete e domosdoshme.
<i>1 (nje) Inxhinier Gjeoteknik</i>	Ne preventivin percaktohen volume konkrete pune te domosdoshme per tu ndjekur nga inxhinieri Gjeoteknik persa i perket volumit te pergjithshem te parashikuar ne preventiv
<i>1 (nje) Inxhinier Mekanik</i>	
<i>1 (nje) Inxhinier Elektroteknik</i>	Ne preventivin percaktohen volume konkrete pune te domosdoshme per tu ndjekur nga inxhinieri Elektroteknik persa i perket volumit te pergjithshem te parashikuar ne preventiv

**2.3.4.** Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** si më poshtë:

- 1 (një) Punonjës Teknik ndërtimi
- 1 (një) Punonjës Teknik Gjeometer
- 1 (një) Punonjës Teknik Topograf
- 1 (një) Punonjës Teknik Mekanik
- 1 (një) Punonjës Teknik Hidraulik
- 1 (një) Punonjës Teknik Elektrik
- 2 (dy) Karpentier
- 2 (dy) Hekurkthyes
- 1 (nje) Saldator
- 2 (dy) Hidraulik
- 2 (dy ) Pllakashtrues
- 2 (dy) Elektricitist



- 2 (dy) Betonues
- 2 (dy) Automakiniste
- 2 (dy) Buldozeriste
- 2 (dy) Eskavatoriste
- 3 (tre ) Shofer
- Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për per 3 muajt e fundit.
- Per inxhinieret te paraqiten diploma perkatese e leshuar nga Institucione Arsimore te Arsimit te Larte te akredituara.
- Per punonjesit e kualifikuar te ndertimit te paraqitet Çertifikatat/diplomat/deshmia te leshuara nga institucione publike/private te licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH “I ndryshuar.
- Për tekniket e ndërtimit dhe teknikun topograf do të pranohet vetem diploma e shkollës së mesme/licence profesionale nga institucionet përkatëse.

**Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.**

-Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojesit	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certifikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					
.....					

2.3.4/b Për punonjesit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë individuale të punës;
- leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit manovrator emer/mbiemer, profil i punes, numri dhe daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.
- Punetoret e mesiperme te figurojne ne listepagesa per periudhen e kerkuar.

**Argumentimi :** Kerkesat e mesiperme jane vendosur ne zbatim te ligjit 162/2020 Per prokurimin Publik dhe VKM- nr. 285 datw 19.05.2021 “ Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” neni 39 pika 6 Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e

saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

- e) Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
- f) Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

**2.3.5 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës si më poshtë:**

- a. 1 (nje) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").
- b. Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1(nje) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.
- c. Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre min. 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për dëmet në mjedis”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e dhënë nga një organizem i licencuar, shqiptar ose i huaj.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- a) Kontrate pune;
- b) diplome/certificate

d. 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave")*.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar.**

Argumentimi: Sipas pikës 2.3.7, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore **minimalisht 80 (tetedhjetë) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve per periudhen 3 muaj nga afati i fundit te mbylljes se ofertave , në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8.

Operatori ekonomik krahas deklaratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj
- Listë pagesat e punonjësve, të konfirmuara nga institucionet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më sipër kërkuar**

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimi. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përlllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.629, date 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përlllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit, orëve të punës, afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë punëtore janë përlllogaritur stafi teknik dhe inxhinierik si dhe stafi administrativ.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, mjedisit dhe menaxhimit të energjisë. Për këtë duhet të paraqesë çertifikatat e mëposhtme:

- a) ISO 9001:2015 mbi “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*” e vlefshme, ose ekuivalente
  - b) OHSAS 18001:2007 mbi “*Shëndetin dhe sigurimin në punë*” e vlefshme, ose ISO 45001:2018 ose ekuivalente
  - c) ISO 14001:2015 mbi “*Sistemet e menaxhimit të ambientit*” e vlefshme, ose ekuivalente
- Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe gjatë periudhës së parashikuar për zbatimin e kontratës.

Argumentimi : Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit.

**2.3.8** Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme” ose të kete kontrate shërbimi noteriale për objektin konkret me shoqëri të licensuara. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, date 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislativën në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”). Licenca duhet të shoqërohet me akt miratimin.

- Operatorët Ekonomik duhet të jetë pajisur me Liçense për Mbrojtje nga Zjarri të lëshuar nga QKL, Kodi I.2.A.

- **Argumentimi** : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: *“leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”*. Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.
- Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”*.
- Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: *“Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”*.
- Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e punimeve objekt prokurimi

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë së bashku me preventivin dhe analizën teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim. Bazuar në VKM nr.514 datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së koston dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë noteriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose nderkombëtar sipas standarteve. Detyrimisht të paraqitet kontrata noteriale.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar mjetet / makinerite të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre “(perlllogaritja e oreve të Punës si edhe të mjeteve të nevojshme) , bazuar në tipologjinë e zërave të preventivit , analizave përkatëse të zërave të preventivit etj, nga specialistet përkatës të inxhinierë, nga grupi i punës për perlllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta teknike të kualifikimit .

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike

të tyre” si edhe nga praktika te meparshme te ngjashme. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

23.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet:

- Hekur
- Tombino me tuba betoni
- Tuba te brinjezuar HDPE SN8
- Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar mjetet / makinerite të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “(perllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , bazuar ne tipollogjine e zerave te preventivit , analizave perkatese te zerave te preventivit etj, nga specialistet perkates te inxhinierë, nga grupi i punes per perllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve te vecanta teknike te kualifikimit .

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” si edhe nga praktika te meparshme te ngjashme. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

2.3.12 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
--------	-------	---------

Kamion vetëshkarkues ( kapaciteti mbajtës 15-20 Ton )	2 cope	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç 8- 10 Ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 3.5-5 ton)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës 1.5 deri ne 2 ton)	2 cope	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 cope	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	1 cope	Pronësi ose me qera
Ekskavator me goma	2 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me Zinxhir	1 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me Zinxhir mbi 20 Ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavator me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Grejder Mjet teknologjik me Goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavator me peshe 3-5 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul hekur-hekur me kapacitet 5-8 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Rrul hekur-gome me kapacitet 12 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Autovinc me Kosh	2 cope	Në pronësi ose me qera
Mini Eksavator me zinxhir	1 copë	Në pronësi ose me qera
Kompaktor	2 cope	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	2 cope	Pronësi ose me qera
Makineri Vijezi	1 cope	Pronësi ose me qera
Tranxhe për perpunimin e hekurit te ndertimit	1 copë	Pronësi ose me qera
Fabrike Asfaltobetonit e pajisur me QKL	1 cope	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi noteriale
Nyje prodhim Inertesh e pajisur me QKL	1 cope	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi noteriale
Linje Prodhimi Betoni me QKL	1 cope	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi noteriale

Fabrike prodhimi te elementeve te betonit me QKL	1 copë	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi noteriale
Aparat Ngjitje Tubash PE, PVC	1 copë	Pronësi ose me qera
Dumper kantieri	2 copë	Pronësi ose me qera
Kontinier-Zyre levizese	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator	4 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	3 copë	Pronësi ose me qera
Saldatrice	2 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator mbi 50kva	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparat topogjeodezik me GPS	1 copë	Pronësi ose me qera
Pajisje P.P.E	10 copë	Në pronësi ose me qera
Pirun Ngrites	2 copë	Në pronësi ose me qera
Elektrosaldatriçe	2 copë	Në pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qera
Moto gjenerator	2copë	Në pronësi ose me qera
Depozite uji (kapaciteti minimal 2000 litra)	2 copë	Në pronësi ose me qera
Betoniere kantieri	5 copë	Në pronësi ose me qera
Depozite per Grumbullim materiale	1 copë	Në pronësi ose me qera
Deflektometer per shtresat e tokes	1 copë	Në pronësi ose me qera
GPS	1 copë	Në pronësi ose me qera
Instrument nivelimi (Teodolid )	1 copë	Në pronësi ose me qera
Vidator	1 copë	Në pronësi ose me qera



Troko	1 copë	Në pronësi ose me qera
Tokomak ngjeshje dheu	4 copë	Në pronësi ose me qera
Pompë Uji	2copë	Në pronësi ose me qera
Fikse Zjarri	20 copë	Në pronësi ose me qera
Karroca	4 copë	Në pronësi ose me qera
Rrjetë Plastike	Rrjetë Plastike	Rrjetë Plastike
Betoforma	300 m2	Në pronësi ose me qera

- **Pajisje të tjera ndihmëse, (të cilat duhet të vërtetohen me deklaratë sipas shtojces perkatëse, të DST:**

Nr	Mjete mbrojtëse	njesia	sasia	statusi
1	Kokore	copë	50	Në pronësi ose me qera
2	Jelek	copë	60	
3	Tabela Sigurimi Teknik	copë	60	Në pronësi ose me qera
4	Kuti Ndhme e shpejt	copë	15	Në pronësi ose me qera
5	Prozhektor për ndricim	copë	10	Në pronësi ose me qera
6	Çizme	copë	15	Në pronësi ose me qera
7	Doreza	copë	15	Në pronësi ose me qera
8	Kominoshe	copë	15	Në pronësi ose me qera
9	Lopat	copë	12	Në pronësi ose me qera

- Për mjetet që regjistrohen ne regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikaten e pronësisë, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë (vetem mjetet e transportit) dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumentet e mesipërme duhet të shoqërohen me kontratën noteriale perkatëse të qerës, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Për mjetet e transportit me qera të paraqitet gjithashtu Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fatura tatimore perkatëse fotot dhe fatura tatimore perkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipërme, duhet të

paraqitet edhe kontrata e qirase noteriale e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.

- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.
- Operatori/Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara do te angazhohen ne kete objekt prokurimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

### 2.3.13 Operatorët ekonomik :Per Impiantin e prodhimit te asfaltobetonit duhet te paraqese Raport Vetemonitorimi planvendosjen dhe projektin teknologjik.

Per Fabriken e Asfalto-Betonit duhet te paraqiten dokumentet e pronesise si akte çdoganimi ose fatura tatimore te blerjes, leja mjedisore e leshuar nga QKL kodi III.1.B + Akt-Miratimin, si dhe Planvendosje e vendodhjes se objektit e cila ne rastin e fabrikes se Asfalto-Betonit nuk duhet te jete ne distance me te madhe se 35 km nga objekti i prokurimit. Ne rastin e fabrikes/linjes me qera/kontrate furnizimi dokumentete e mesiperme duhet te shoqerohen me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Operatori ekonomik duhet te deklaroje vendodhjen e sakte te impiantit, te paraqese planin e vendosjes dhe fotografi te impiantit (referuar percaktimeve te VKM 628 DT 15.07.2015). Perjashtohen rastet kur Impianti eshte mobile (i levizshem). Ne kete rast operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin ligjor qe vereteton pronesine e tij (fature tatimore/zhdoganimi ose kontrate shitblerjeje si dhe e shoqeruar me foto).

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

## NJESIA E PROKURIMIT